

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 и 51/11 dhe “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 96/19 dhe 110/19), si dhe në bazë të nenit 22 dhe nenit 25 të Ligjit për arsim të mesëm (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.44/95, 24/96,34/96, 35/97, 82/99,29/2002,40/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011,51/2011,6/2012,100/2012,24/2013,41/2014,116/2014,135/2014,135/2014,10/2015,98/2015,145/2015,30/2016,127/2016,67/2017dhe 48/2018) ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcaktoi programin e shkurtuar mësimor në lëndën mësimore *arti figurativ* për vitin e parë (I) në gjimnaz për vitin shkollor 2020/2021.

1. HYRJE

Programi mësimor i shkurtuar për lëndën *arti figurativ për vitin I (e parë)* në gjimnaz për vitin shkollor 2020/21 bazohet në qëllimet/rezultatet e pritura të parashikuara nga programi mësimor për lëndën mësimore që rregullisht realizohet në përputhje me planin mësimor.

Me programin e shkurtuar përcaktohen temat e caktuara dhe njësitë mësimore që duhet të realizohen në 159 ditë mësimore, gjatë së cilës duhet të merret parasysh fondi javor i orëve të përcaktuara në programin e rregullt, domethënë për një lëndë me 2 orë në javë parashihen 64 orë në programin e shkurtuar.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e pritura, termet e përcaktuara, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

2. PASQYRA E TEMAVE DHE NJËSITË MËSIMORE

Tema: **Vizatim** (orientim 16 orë)

Njësitë mësimore

- Hyrje në material. Fushat artistike. Vizatimi. Llojet e vizatimit
- Elementet figurative dhe parimet (TIK)
- Vija, drejtimi;
- Tekstura (TIK);
- Pejzazhi;
- Madhësia, proporcioni (TIK);
- Portreti;

- Lëvizja dhe ritmi;
- Llojet e ritmit (muzika);
- Hapësira, perspektiva në vizatim (TIK);
- Pejzash urban.

Tema: **Pikturimi** (orientim 22 orë)

Njësitë mësimore:

- Pikturimi, teknikat e pikturimit.
Ngjyra – ndarja e ngjyrave (TIK)
- Ngjyra, harmonia e ngjyrave. (TIK)
Harmonia e analogjisë dhe triada – ëndrra, rrugëtimi
- Kontrasti i ngjyrave (TIK)
Kontrasti komplementar, loja
- Toni – shkalla e tonit (TIK)
Shkallët kromatike dhe akromatike të toneve;
- Modelimi dhe modulimi (TIK)
Natyra e vdekur - pastelev
- Llojet e kompozicionit (TIK)
Aktiviteti figurativ – natyra e vdekur;
- Theksi – grafitët - teknika (TIK)
(EKO: Ndikimi i njeriut mbi mjedisin)

Tema: **Skulptura** (orientim 7 orë)

Njësitë mësimore:

- Skulptura. Teknikat e skulpturës (TIK)
Llojet e formave
- Baraspesha, simetria dhe asimetria – kompozicioni i lirë - asamblesh - (TIK) – EKO: Ripërdorimi

Tema: **Grafika** (orientim 6 orë)

Njësitë mësimore:

- Grafika dhe teknikat grafike (TIK)
Kontrasti - skicë për gravurë në linë
- Çelësi dur - kontrasti i toneve
Kompozicioni i lirë – skicë për gravurë në linë

Tema: **Dizajni** (orientim 13 orë)

Njësitë mësimore:

- Dizajni grafik - dizajn në pllakat – EKO
(Përdorimi i transporti publik dhe biçikleta)
- Dizajni grafik - Proporcionet. Prerje e artë (TIK)
Kopertina e librit- teknika e kombinuar
- Kaligrafia, ritmi, teksti
Dekorimi i tekstit (EKO- Përpunimi i udhëzimeve për përdorimin racional të ujit)
- Dizajni skenik. Hapësira. (TIK)
Zgjidhja ideore për skenografi
- Dizajni i tekstilit dhe veshjes – Kostumi historik – ngjyra, forma (TIK)
Teknikat e kombinuara

3. REKOMANDIME DIDAKTIKE

Programi mësimor i shkurtuar në lëndën *artit figurativ për vitin I* (e parë) të arsimit të mesëm gjimnaz me një kohëzgjatje katërvjeçare për vitin akademik 2020/21 do të realizohet në 64 orë mësimore. Përmbajtjet mësimore nga programi mbeten të njëjta por të shpërndara në kuadër të 64 orëve mësimore. Është bërë bashkim i përmbajtjeve mësimore të temave të njëjta dhe të ndryshme duke mbajtur llogari për lidhshmërinë logjike në mes tyre. Rekomandohet mësimdhënësi gjatë realizimit të orës mësimore në të cilën ka të integruar dy ose më tepër përmbajtje mësimore të mbaj llogari për vëllimin e materies mësimore. Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e mësimimit, nocionet e përcaktuara, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara me programin e rregullt mësimor. Në këtë program nuk janë paraparë orët e veçanta për përsëritje dhe përcaktimin e materialit.

Përcjelljen e të arriturave të nxënësve mësimdhënësi individualisht e integron në kuadër të orëve të parapara për realizim, duke përdorur metoda, teknika dhe instrumente të ndryshme. Informata kthyesë në kohë dhe konstruktive u mundëson nxënësve t'i identifikojnë hapat e ardhshëm të nevojshëm që të përparojnë në mësim.

Rekomandimet për fondin vjetor të orëve janë dhënë në mënyrë orientuese së bashku me qëllimet temat dhe përmbajtjet konkrete. Mësimdhënësi nuk kufizohet në shpërndarjen e temave dhe përmbajtjeve sipas nevojave gjatë realizimit por sipas kreativitetit individual dhe sipas të arriturave të nxënësve.

4. NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR

Programin e shkurtuar mësimor e realizon mësimdhënësi në pajtim me normativin për kuadrin mësimor të dhënë në programin e rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor nga *arti figurativ për vitin I* (e parë) të arsimit të mesëm gjimnaz për vitin shkollor 2020/21 e përcaktoi

Ministër i Arsimit dhe Shkencës

Milla Carovska